

Hapet Thirrja për Aplikime për Bursa Mobiliteti për Stafin Akademik dhe Administrativ në Universitetin Kodolanyi Janos të Shkencave të Aplikuara, në Hungari, në Kuadër të Programit Erasmus +, për periudhën 3-7 Prill 2017

Në kuadër të programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për Stafin Akademik dhe Administrativ të Universitetit të Tiranës në Universitetin Kodolanyi Janos të Shkencave të Aplikuara, në Hungari, për periudhën 3-7 Prill 2017.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e stafit akademik për mësimdhënie;
- Shkëmbimin e stafit administrativ për trajnim;

Kohëzgjatja e bursave:

- Mobiliteti për mësimdhënie/trajnim (5 ditë)

Fushat e mobilitetit për stafin akademik:

- Studime Ndërkombëtare;
- Studime Sociale;
- Studime Kulturore;
- Shkenca Humane;
- Turizëm;
- Biznes;

Bursat përfshijnë:

- Kompensimi ditor (140 EUR në ditë për stafin);
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni link-ut:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

➤ **Dokumentat e nevojshme për aplikim për stafin akademik për mësimdhënie:**

- CV+ lista e publikimeve (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Letër motivimi (në gjuhën angleze);
- Vërtetim Punësimi (në gjuhën shqipe);
- Certifikata e gjuhës së huaj që vërteton njohuritë e gjuhës angleze në nivelin B2 ose hungarisht B2 në varësi të programit të mësimdhënies;
- Plani i mobilitetit për mësimdhënie*;

**Mobility Plan është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar aktivitetet që do të zhvillohen gjatë periudhës së mobilitetit. Ky dokument firmoset nga aplikanti dhe në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus + Z. Elton Skendaj.*

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit për Mësimdhënie klikoni në adresën: http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Teaching_Mobility_Plan.pdf

➤ **Dokumentat e nevojshme për aplikim për stafin administrativ për trajnim:**

- CV (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Letër motivimi (në gjuhën angleze);
- Vërtetim Punësimi (në gjuhën shqipe);
- Certifikata e gjuhës së huaj që vërteton njohuritë e gjuhës angleze në nivelin B2;

- Plani i mobilitetit për trajnim*;

**Mobility Plan është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar aktivitetet që do të zhvillohen gjatë periudhës së mobilitetit. Ky dokument firmoset nga aplikanti dhe në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus + Z. Elton Skendaj.*

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit për Trajnim klikoni në adresën:
http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Training_Mobility_Plan.pdf

Afati për aplikime: 27 Shkurt 2017

Dokumentet duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Komunikimit, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin iro@unitir.edu.al me subjekt: “Aplikim për bursë në Universitetin Kodolanyi Janos të Shkencave të Aplikuara, emrin dhe mbiemrin tuaj”.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën:
iro@unitir.edu.al

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikim!